Siguri

Ekskluzive | Kapet me armë në brez në Koshutovë – 23 vjeçari përfundon në ndalim

Sinjali.com 10 Maj 2026 22:40

Një 23-vjeçar është arrestuar të shtunën në Leposaviç pasi njësitë speciale policore i gjetën armë zjarri gjatë kontrollit, mëson Sinjali nga burime të afërta me hetimin.

Burimet bëjnë të ditur se bëhet fjalë për ***Rion Begiqin***, i cili u ndalua nga njësia NJNSH-Lindje në fshatin Koshutovë.

Sipas informatave, gjatë kontrollit sipërfaqësor policor, te Begiqi është gjetur një armë brezi, pistoletë me katër fishekë të kalibrit 9 mm, për të cilën nuk posedonte leje.

Pas zbulimit të armës, Policia e arrestoi menjëherë 23-vjeçarin, ndërsa arma dhe fishekët u sekuestruan si prova materiale.

Sinjali mëson se pas intervistimit në prezencë të avokatit mbrojtës, me urdhër të Prokurorit të Shtetit, Rion Begiqi është dërguar në mbajtje për 48 orë.

Rasti po hetohet si "Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.

All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com